



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:284133  
Datë: 20.02.2025  
Numri i dokumentit: 06877517

C.nr.4272/22

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Shaban Shala, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional L.Ç. në çështjen juridike kontestimore të paditësve Gj.B. me numër personal ..... Z.K. me numër personal ..... M.P. me numër personal .... K.B. me numër personal ..... A.P. me numër personal ..... që të gjithë të punësuar pranë SHFMU “Fatmir Berisha”, në Prizren, të cilët me autorizim i përfaqëson avokat N.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 19.02.2025, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**(Pa shqyrtim kryesor)**

**I. APROVOHET** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve **Gj.B., Z.K., M.P., K. B. dhe A.P.** me të cilën kanë kërkuar kompensimin e shkallës së inflacionit, ashtu që, **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit të kompensohen në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

- Për paditësin **Gj.B.** për periudhën kohore 29.12.2019 – 21.11.2022, shumën prej 405.55 euro;

- Për paditësen **Z.K.** për periudhën kohore 29.12.2019 – 21.11.2022, shumën prej 704.35 euro;

- Për paditësen **M.P.** për periudhën kohore 29.12.2019 – 21.11.2022, shumën prej 704.35 euro;

- Për paditësen **K.B.** për periudhën kohore 29.12.2019 – 21.11.2022, shumën prej 704.35 euro;

- Për paditësin **A.P.** për periudhën kohore 29.12.2019 – 21.11.2022, shumën prej 704.35 euro;

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 3,222.95 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (29.12.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

**II. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën I. të këtij dispozitivi në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore 01.01.2019 – 29.12.2019 dhe atë për paditësin G.B. shumën prej 156.53 euro, ndërsa për paditësit e tjerë, për secilin nga 272.55 euro, si e parashkruar.

**III. DETYROHET** e paditura, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve t'ua paguaj shumën prej 333.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

### Arsyetim

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, në këtë gjykatë me datë 29.12.2022, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën kanë kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, konkretisht për vitet 2017 – 2021. Shpenzimet gjyqësore i kanë kërkuar. Të njëjtit me datë 16.03.2023, pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar parashtrësën me të cilën kanë precizuar kërkesëpadinë me të cilën kanë kërkuar ti njihet e drejta e kompensimit të inflacionit, për periudhën kohore 2019 – 2022, për paditësin Gj.B. shumën prej 562.08 euro, për paditësin Z.K., shumën prej 976.90 euro, për paditësin M.P. shumën prej 976.90 euro, për paditësin K.B. shumën prej 976.90 euro dhe për paditësin A.P. shumën prej 976.90 euro. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar në shumën prej 645 euro dhe kamatën ligjore prej 8%.

E paditura, në përgjigjen në padi të paraqitur në këtë gjykatë me datë 26.02.2024, e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar, duke theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësve se ju takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësit ushtrojnë padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se ju takojnë beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe

1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Tutje ka shtuar se e drejta për kompensim të inflacionit prej vitit 2017 e deri në parashtrimin e padisë, është parashkruar, sipas nenit 353 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve kjo e drejtë është parashkruar. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se të nejtat janë të punësuar pranë SHFMU "Fatmir Berisha", në Prizren, konkretisht në bazë të provave dhe atë për paditësin Gj.B. kontrata e punës me numër 123/21, ku paga bazë shihet 242.38 euro dhe vërtetimi me numër 93/22, i datës 25.02.2022, për paditësen Z.K. kontrata e punës me numër 15, e datës 26.10.2015 dhe vërtetimi me numër 118/22, i datës 25.02.2022, kontrata e punës për paditësen M.P. me numër 43, e datës 26.10.2015 dhe vërtetimi me numër 102/22, i datës 25.02.2022, kontrata e punës me numër 271/20, e datës 18.09.2020 në emër të paditëses K.B. dhe vërtetimi me numër 98/22, i datës 25.02.2022, kontrata e punës me numër 62, e datës 23.10.2015 në emër të paditëses A.P. dhe vërtetimi me numër 76/22, i datës 25.02.2022. Gjithashtu ka administruar listën e pagave me numër 10-94479-622-0912, sipas së cilës listë paga bazë për mësimdhënësit, këtu paditësit kanë pasur pagë bazë 421 euro.

Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se "*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*".

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se "*Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë*", si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që "*Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të*

*Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit iu takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlogaritjes së bërë në këtë mënyrë: Për vitin 2020, shkalla e inflacionit 0.2%, për pagën bazë 421 euro, për vitin 2021, shkalla e inflacionit 3.4%, për pagën bazë 421 euro, si dhe për vitin 2022, shkalla e inflacionit 11.6%, për pagën bazë 421 euro, ashtu që u ka njohur të drejtën e kompensimit në këtë formë: Për paditësin Gj.B. për periudhën kohore 29.12.2019 – 21.11.2022, shumën prej 405.55 euro, për pagën bazë 242.38 euro, për paditësen Z.K. për periudhën kohore 29.12.2019 – 21.11.2022, shumën prej 704.35 euro, për pagën bazë 421 euro, për paditësen M.P. për periudhën kohore 29.12.2019 – 21.11.2022, shumën prej 704.35 euro, për pagën bazë 421 euro, për paditësen K.B. për periudhën kohore 29.12.2019 – 21.11.2022, shumën prej 704.35 euro, për pagën bazë 421 euro, për paditësin A.P. për periudhën kohore 29.12.2019 – 21.11.2022, shumën prej 704.35 euro, për pagën bazë 421 euro, të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 3,222.95 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (29.12.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.*

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”,* ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh afatin e parashkrimit për kërkesat nga marrëdhënia e punës parashkruhen në afat prej 3 vitesh, konkretisht në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.* Andaj, gjykata vendosi që të refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë sa i përket inflacionit, për periudhën kohore 01.01.2019 – 29.12.2019 dhe atë për paditësin G.B. shumën prej 156.53 euro, ndërsa për paditësit e tjerë, për secilin nga 272.55 euro, si e parashkruar, pasi që për këtë periudhë kohore ka kaluar afati i parashkrimit, pasi që padia është paraqitur me datë 29.12.2022.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashkrimit të padisë në këtë gjykatë (29.12.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par.1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 333.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 312.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20.00 euro. Ndërsa, ka vendosur të refuzojë pjesën tjetër të kompensimit të shpenzimeve gjyqësore, konkretisht për përpilimin e parashtresës për precizimin e kërkesëpadisë, pasi që gjykata konstaton se këto shpenzime nuk janë kërkuar me fajin e të paditurës, andaj konform dispozitave të LPK-së ka vendosur të refuzojë këto shpenzime, konkretisht në shumën prej 312 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 dhe 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**

**-Departamenti i përgjithshëm-**

**C.nr.4272/22, dt.19.02.2025**

**Gjyqtari**

---

**Shaban Sh Shala**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.